



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	09.07.20	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Nupri		Shtojcë	
09	310/01-15997-X			

Kuvendi i Komunës  
Skupština Opština  
Municipal Assambly

## KONTRATA PËR SHËRBIME

**Komuna e Kaçanikut** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), i përfaqësuar nga **Shefket Koxha – Menaxher i prokurimit**; në njëren anë dhe

**Sefedin Heta B.I. nga Gllogovci** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), i përfaqësuar nga i autorizuar **Sefedin Heta** ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

### Dezinfektimi i objekteve shkolllore

me numër Identifikues **KA652/20/029/236**

#### Neni 1 Lënda

##### 1.1 Lënda e kontratës do të **Dezinfektimi i objekteve shkolllore**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **09.07.2020**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më se jo 2 ditë nga data e porosisë mvarësisht nga situata në teren dhe përfundon më 20.12.2020.

1.4 Vendi **Objektet komunale në teritorin e Komunës së Kaçanikut.**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

#### Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridikioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

#### Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **0.05 €.; me fjalë ( pesëcentë) ky qmim është qmim për njës mvarësisht nga nevojat e krijuara nga pandemija, vlera e përafërt e parashikur është 9925.00€.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

#### Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro në llogarin Bankare).

#### Autoriteti Kontraktues do të pagua) OE dhe atë pas pranimit të shërbimit

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

#### Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

#### Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

#### Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid sipas kërkesave në DT, pas pranimit të **shërbimit**.

#### Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin **[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [te realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët]** brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[furnizimeve] [punëve] [shërbimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

#### Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për

mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

#### Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktesuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

#### Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën komunale në Kaçanik në pajtim me ligjin e Kosovës.


#### Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen Shqip në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Sefedin Heta	Emri:	Shefket Koxha
Pozita:	Drejtore	Pozita:	Menagjer i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	08.07.2020	Data:	08.07.2020
Vula:		Vula:	

## Pjesa II. LISTA E ÇMIMEVE

**Titulli: Shërbimet e dezinfektimit në hapësirat të objekteve shkollore te AK-së sipas kërkesave dhe nevojave të AK-se**

1	2	3	4	5	6=(4X5)
Nr.	Përshkrimi (Referoju specifikimeve teknike të kérkuara në Aneksin 1 në faqen nr. 21 në dosjen e tenderit)	Njësia matëse	Sasia e sipërfaçes	Çmimi për njësi me TVSH € (për m <sup>2</sup> )	Çmimi Total për njësi me TVSH €
1	Shërbimet e dezinfektimit të hapësirave të AK-së sipas kërkesave dhe nevojave të AK-se	m <sup>2</sup>	1	0.05	0.05
TOTALI I PËRGJITSHËM PËR NJËSI:					0.05
Në çmim janë të llogarituara të gjitha laksat, tatiimet dhe detyrimet e aplikueshme me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës					

- Në çmimin për m<sup>2</sup> duhet të llogariten të gjitha shpenzimet lidhur me dezinfektimin e hapësirave dhe shpenzimet tjera përcjellëse të dezinfektimit të hapësirave të AK-së që janë kérkuar në Aneksin 1 të specifikimeve teknike në dosjen e tenderit.
- Pagesa do te behet ne baze te raportit te dorëzuar me shkrim nga Menaxheri i Projektit pranë AK-së lidhur me sherbimet e dezinfektimit te hapesirave te pranuara ne gjendje te rregullt te shprehur ne m<sup>2</sup> dhe do të aplikohet çmimi për njësi i kontratës kornizë.

Identifikimi i operatorit ekonomik (oe)	
Emri i OE:	N.SH.AMBULANCA VETERINARE "VETERINA"
Emri dhe mbiemri i perfaçuesit te OE:	SEFEDIN HETA
Nënshkrimi:	
Data:	11.06.2020
Vula:	